



# KUVENDI YNË

Prishtinë, Maj 2013



# KUVENDI YNË

Prishtinë, Maj 2013

## **Anëtarët e grupit punues**

### **Arben Kelmendi**

*Menaxher i Programit, NDI*

### **Flora Kryeziu**

*Zyrtare e Programit, UNICEF*

### **Musli Krasniqi**


*Zyrtar për marrëdhënie me publikun,  
Kuvendi i Kosovës*

### **Arta Qorri**


*Zyrtare e Programit, NDI*

*Ilustrimet i punoi*


**Faton Mikullovc**



JAVËN E KALUAR  
VIZITUAM KUVENDIN E KOSOVËS.  
NE KISHIM PLANIFIKUAR KËTË  
VIZITË SI PJESË TË LËNDËS SË  
EDUKATËS QYTETARE.



VENDI YNË  
ËSHTË DEMOKRACI  
PARLAMENTARE ME TRI DEGË  
TË NDARA TË PUSHTETIT:  
LIGJVËNËS, EKZEKUTIV  
DHE GJYQËSOR.




KUVENDI ËSHTE  
INSTITUCIONI MË  
I LARTË LIGJVËNËS  
DHE PËRFAQËSUES.

AI MIRATON  
LIGJET DHE MBIKËQYRË  
PUNËN E QEVERISË.



DEPUTETËT JANË  
TË ZGJEDHURIT  
E QYTETARËVE, TË CILËT  
PËRFAQËSOJNË QYTETARËT  
DHE MARRIN VENDIME  
NË EMËR TË TYRE.

NË HOLLIN KRYESOR  
NA PRITI DEPUTETJA, E CILA  
ISHTE EDHE NIKOQIRJA JONË.  
KUVENDI KA 120 DEPUTETË  
NGA GJITHË VENDI YNË.




DEPUTETJA NA  
TREGOI ZYRËN E SAJ,  
KU AJO PO PËRGATITEJ  
PËR DEBATIN E SOTËM PËR  
SIGURINË NË SHKOLLAT TONA.  
AJO ME SHUMË INTERES  
DËGJOI MENDIMIN TONË  
RRETH KËSAJ TEME.






KUR SEANCA FILLOI,  
NE NA DËRGUAN NË GALERINË  
E VIZITORËVE, PREJ NGA  
PËRCOLLËM DEBATIN.


ÇDO QYTETAR  
MUND TË VIZITOJ KUVENDIN,  
NËSE PARAQET KËRKESËN  
NË ZYREN PËR MARRËDHËNIE  
ME PUBLIKUN NË KUVEND.






DEBATI PËR  
SIGURINË NË SHKOLLA ISHTE  
PJESA MË INTERESANTE E  
SEANCËS SË SOTME.

GJATË FJALIMIT  
TË SAJ, NIKOQIRJA JONË  
PËRMENDI EDHE DISA NGA  
SHQETËSIMET QË I NGRITËM  
NË ZYREN E SAJ.




NE FUND TË DEBATIT,  
DEPUTETËT VOTUAN  
PROPOZIMIN E KOMISIONIT  
PËR ARSIM.

KËTË VOTIM  
E PAMË EDHE NË LAJMET  
E MBRËMJES.



NJË PJESË TJETËR  
INTERESANTE E SEANCËS  
ISHTE EDHE KOHA PËR  
PYETJE PARLAMENTARE.

PLOT NJË ORË,  
DEPUTETËT U BËNIN PYETJE  
MINISTRAVE TË QEVERISË RRETH PUNËS  
SË TYRE DHE U SUGJERONIN MËNYRA  
PËR TË PËRMIRËSUAR ATË.




MË VONË SHKUAM  
NË NJËRËN NGA SALLAT E KOMISIONEVE.  
KOMISIONET E KUVENDIT JANË GRUPE  
MË TË VOGLA TË DEPUTETËVE QË MERRREN  
ME ÇËSHTJET E NJË FUSHE TË ÇAKTUAR.

KUVENDI YNË KA  
TREMËDËDHJETË KOMISIONE,  
TË CILAT MBULOJNË FUSHAT SI:  
BUXHETIN, ARSIMIN, SHËNDETËSINË,  
TRANSPORTIN ETJ.




NIKOQIRJA JONË ËSHTE  
ANËTARE E KOMISIONIT PËR ARSIM,  
I CILI SHQYRTON TË GJITHA ÇËSHTJET  
QË KANË TË BËJNË ME SISTEMIN  
TONË ARSIMOR.

KY KOMISION KËRKOI  
DEBATIN E SOTËM PËR  
SIGURINË NË SHKOLLA.



NË FUND TË VIZITËS  
SONË NË KUVEND, PAMË EDHE  
QENDRËN E VIZITORËVE.

ISHTE PËRPLOT  
FOTOGRAFI DHE PUBLIKIME  
TË NDRYSHME QË SPJEGONIN  
PUNËN NË KUVEND.



ATË DITË, NE MËSUAM  
SHUMË PËR PUNËN E KUVENDIT.  
TË GJITHË MOSHATARËT TANË  
DO TË DUHEJ TË VIZITONIN  
KUVENDIN SË PAKU NJË HERË.

PUNA E DEPUTETIT  
ËSHTË VËRTETË E RËNDËSISHME  
PËR VENDIN TONË. KUR TË RRITEM,  
DO TË DËSHIROJA  
TË BËHESHA DEPUTET.



Ju mund të mësoni më shumë rreth punës së Kuvendit  
dhe mënyrës se si parashtrohet kërkesa për vizitë, në

[www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org)



---

Ky publikim është mundësuar nga  
Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)  
dhe Instituti Demokratik Kombëtar (NDI)

---

